

Data: 05.05.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**“KITE DHE REAGENTË PËR LABORATORËT E SHËNDETIT PUBLIK TË NJËSISË
VENDORE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DURRËS”.**

KONTRATË

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): *Mbajtës
mjetesh laboratorike 42671100-1, Pipeta 38437100-8, Artikuj qelqi për përdorim laboratorik,
higjienik ose farmaceutik 33790000-4, reagente per analizat e gjakut 33696200-7, reagente
kimike 3369300-8, reagente per laborator 33696500-0, artikuj farmaceutike 33680000-0.*

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,500,000 (tre milion e pesëqindë mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për*

Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **39% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.**

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një

kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet : c) 40 % vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme”.

Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 55 pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 55 pika 4/b VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. përcaktohet se: “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme çka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshëm dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA / deklaratë konformiteti CE ose FDA (aty ku eshte e aplikueshme) për mallrat objekt prokurimi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në pikën 1 të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 79 pika 1 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet,

objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Në nenin 44 pika 1 të të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore," i ndryshuar, ku në nenin 17 të tij përcaktohet se: *“1. Konformiteti i pajisjes mjekësore me kërkesat thelbësore konfirmohet nga lëshimi i dokumentit të konformitetit të markimit CE. 1/1. Konformiteti i pajisjes mjekësore me kërkesat thelbësore konfirmohet nga lëshimi i dokumentit të certifikimit FDA. 2. Prodhuesi i pajisjes mjekësore, për të vendosur markimin CE ose certifikimit FDA, sipas çdo klasifikimi pajisjeje, ndjek procedurën e vlerësimit të konformitetit, të përcaktuar në rregullat teknike për kërkesat thelbësore, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. 3. Markimi CE nuk është i nevojshëm për pajisjet mjekësore të destinuara për hetime klinike dhe për pajisje me porosi. 4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë ka të drejtë, nëse është paraqitur një kërkesë e arsyetuar për këtë qëllim, të lejojë vendosjen në treg dhe përdorimin e pajisjeve mjekësore të veçanta, për të cilat nuk janë ndjekur procedurat për vlerësimin e konformitetit, të parashikuara në këtë nen, me kusht që përdorimi i këtyre pajisjeve të jetë absolutisht i nevojshëm për mbrojtjen e shëndetit publik.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike. Certifikatat e konformitetit CE (ose deklarata e konformitetit CE nëse është rasti) ose FDA approval janë dokumente të rëndësishme që vërtetojnë përputhjen e produkteve me standardet e sigurisë dhe cilësisë. Theksohet se malli objekt prokurimi kanë si destinacion final Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës, dhe duke vijuar arsyetimin për rëndësinë e këtij shërbimi për furnizimin me materilet mjekësore, është e domosdoshme që furnizimet të jenë cilësore dhe konform rregullave të parashikuara nga aktet e BE (për konformitetin CE) ose të Shteteve të Bashkuara (Për aprovimin FDA).

3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike/katalog teknik nga prodhuesi për të gjitha mallrat objekt prokurimi, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara. Në katalog/skedë duhet të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mallrave të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për*

të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallit që kërkohet, të cilat janë të rëndësishme për punën e Laboratorit të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si katalog/ skedë teknike nga prodhuesi i mallit. Gjithashtu katalogët/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

4.Operatori ekonomik duhet të paraqese certifikimin ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në përputhje me nenin 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë" të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Sa më sipër, ky

kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku të deklarojë se afati i skadencës së mallrave objekt prokurimi, do të jetë sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”. Nisur nga malli objekt prokurimi, furnizimi i kiteve dhe materialeve të konsumit për depistimin e HPV-së dhe referuar shtojcës 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, në specifikimet teknike janë parashikuar afatet e skadencës së mallrave nga momentin e dorëzimit të tyre në Autoritetin Kontraktor. Me anë të këtij kriteri kërkohet që t’i ofrohet siguri Autoritetit kontraktor përfitues mbi afatin e skadencës së mallit që kërkohen. Referuar specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, ky kriter është në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë oferten teknike, për të gjitha artikujt e kërkuar, në formë tabelle, ku të plotësohet:

Emërtimi i artikullit	Emri, Adresa, Website Kompanisë Prodhuese ose Distributorit të Autorizuar	Vendi i origjines	NR. Katallogut/skedës teknike produktit	Faqes të	NR. Identifikues i Produktit (kodi) sipas Katallogut/skedës teknike	Shënime nëse është rasti

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë

se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. ”. Ne kete kontekst eshte kerkuar dhe oferta teknike në formë deklarative, me ane te se ciles do te behet i mundur verifikimi me i sakte i artikujve te ofertuar, origjina, konformiteti me dokumentacionin mbeshtetes te paraqitur nga ofertuesi. Duke marrë shkas nga kompleksiteti i artikujve objekt prokurimi, gjykohet e nevojshme që gjatë fazës së vlerësimit komisioni i vlerësimit të ofertave të njihet me ofertën teknike, për të bërë të mundur një vlerësim sa më eficient dhe sa më të mirëorientuar.

7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit me objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues konform specifikimeve teknike.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendndodhjen përkatëse të caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nr	EMERTIMI	Sasia	Specifikimet Teknike
1	Pepton	11 (njëmbëdhjetë) flakon	flak.500 gr në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyre të verdhë të lehtë
2	Kliger Iron Agar	1 (një) flakon	flak.500 gr në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen me ngjyre të bardhë.
3	Sabouraud-Dextrose agar+chloramphenicol	3 (Tre) flakon	flak.500 gr Pluhur me ngjyrë të verdhë në kuti plastike të mbyllur hermetikisht
4	Chloramphenicol	3 (tre) flakon	Flak.100gr, në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyrë të verdhë
5	C.L.E.D-Agar	2 (dy) flakon	flak.500 gr në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyre jeshile
6	Desoxycholate-citrate-agar	2 (dy) flakon	flak.500 gr në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyrë bezhë të lehtë.
7	X L D –agar	2 (dy) flakon	flak.500 gr në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyre bezhë të lehtë.

8	Agar-Agar	1(një)flakon	Flak.500 gr në shishe plastike te polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyrë bezhë të lehtë.
9	E C-Broth	3(tre)flakon	flak.500 gr në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyrë bezhë të lehtë
10	Aesculin Bile Azid Broth	8(tetë)flakon	flakon 500gr në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyrë bezhë të lehtë
11	Potassium Dyhydrogen Fosfat KH ₂ PO ₄	1(një)flakon	flak.500 gr në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyre te bardhë
12	DyPotassium Dyhydrogen Fosfat (K ₂ HPO ₄)	2(dy)flakon	flak.500 gr në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyre te bardhë
13	Agar-gjak I gatshem	2180(dymij e njeqind e tetëdhjetë) pjata petri	pjata petri plastike 90mm, terren I ngurte ne ngjyre të kuqe. Përmasat e pjatës kërkohen fikse për arësyen e saktësisë së analizave që kryhen në laborator.
14	Trypton-tryptrophan	1(një)flakon	Flakon 500 gr, në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyrë bezhë të lehtë
15	Endo Agar	1(një)flakon	Flakon 500gr, në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë

			(HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyrë lejla, I mbyllur hermetikisht
16	Ekstrakt Majaje	1(një)flakon	Flakon500gr në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. Pluhur homogjen në ngjyrë bezhë të lehtë.
17	Celuloid nitrat filter AC, SC 47mm	5000(tremije)cope	Filter me diameter 47 mm, në cope, filtrat duhen në këtë përmasë për arësye se diametri i aparatit është 47mm
18	Ekstrat Mishi	1(një)flakon	Flakon500gr, në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. pluhur në ngjyrë kremi.
19	Kripe Biliare	1(një)flakon	Flakon 500 gr, në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. pluhur në ngjyrë kremi.
20	Baird-Parker	1(një)flakon	Flakon 500 gr, në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. pluhur ne ngjyre kremi
21	Laktoze	1(një)flakon	Flakon 1kg, në shishe plastike të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) të mbyllur hermetikisht. pluhur në ngjyrë të bardhë
22	Enterotube	4x10 paketa	40 paketa
23	Methicilline	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
24	Bacitracine	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
25	Amikacin	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)

26	Amoxicillin	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
27	Amoxiciline+Ac.Clavvulonik	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
28	Ampicilin	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
29	Azithromycin	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
30	Cefotaxime 5 µg	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
31	Clarithromycine	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
32	Clindamycine	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
33	Eritromycine	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
34	Cefuroxime	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
35	Ceftriaxone	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
36	Ceftazidime 10 µg	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
37	Cefocitin 30 µg	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
38	Choramphenicol	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
39	Meropenem 10 µg	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
40	Ertapenem 10 µg	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
41	Imipenem 10 µg	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
42	Vancomycine 5 µg	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
43	Rifampine	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
44	Ciprofloxcacin	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
45	Doxacyclin	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
46	Fosfomicine	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
47	Gentamycine	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
48	Ac. nalidixic	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
49	Nitrofurantoin	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
50	Norfloxacin	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)

51	Metrondazol	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
52	Tobramycine	30(tridhjete)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
53	Cefaclor	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
54	Cefipine	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
55	Cefixime	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
56	Cephalexin	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
57	Levoflocacine	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
58	Optochine	30(tridhjetë)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
59	Clotrimazol	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
60	Nistatin	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
61	Fluconazole	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
62	Econazole	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
63	Ketoconazole	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
64	Myconazole	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
65	Amphotericin B	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
66	Itraconazole	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
67	Trimethoprim/Sulfamethaxazole	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
68	Flucitozine	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
69	Voriconazole	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
70	Griseofulvin	35(tridhjete e pese)	Shufra, (1 shufer 50 disqe)
71	Typhy O	1(një)flakon	Flakon i lëngshem në shishe qelqi në sasi jo më pak se 5ml dhe jo më shumë se 6ml, të mbyllur hermetikisht
72	Typhy H	1(një)flakon	Flakon i lëngshem në shishe qelqi në sasi jo më pak se 5ml dhe jo më shumë se 6ml, të mbyllur hermetikisht

73	Brucella abortus	1(një)flakon	Flakon i lëngshem në shishe qelqi në sasi jo më pak se 5ml dhe jo më shumë se 6ml në ngjyrë blu, të mbyllur hermetikisht
74	Brucella abortus kontroll pozitiv+negative	1(një)flakon	Flakon i lëngshem në shishe qelqi në sasi jo më pak se 5ml dhe jo më shumë se 6ml, të mbyllur hermetikisht
75	Bromthymol blue C ₂₇ H ₂₈ Br ₂ O ₅ S	1(një)flakon	Flakon 100 gr ngjyrë lejla në shishe qelqi I mbyllur hermetikisht
76	Supplement CCDA	10gr	10 gr, pluhur ne ngjyre të verdhë i mbyllur hermetikisht
77	Test me fryme per ID urea (13 c) per Helicobakter Pylori	2x10 teste	20 teste një përdorimësh të mbyllur hermetikisht
78	Test diferencues per identifikimin e Crypto-Gardia-Entamoeba (Test I shpejte)	20(njëzet) teste	20 teste një përdorimësh të mbyllur hermetikisht
79	Rosolic Acid	10 gr	10 gr pluhur në ngjyrë rozë I mbyllur hermetikisht
80	Calprotectine fecal test	20 (njëzet) teste	20 Teste të shpejtë imunokromatografik një përdorimësh, paketim individual
81	Test I shpejte HBsAg	1140(njëmijë e njëqind e dyzet) teste	Teste të shpejtë imunokromatografik, një përdorimësh, paketim individual
82	Test I shpejte HCV	1080(njëmijë e tetëdhjetë) teste	Teste të shpejtë imunokromatografik, një përdorimësh, paketim individual

83	Test I shpejte HIV 1+HIV 2	300(treqind) teste	Teste të shpejtë imunokromatografik ,një përdorimësh, paketim individual
84	Sistem për identifikimin e shkaktareve të infeksioneve urinare	30(tridhjetë) teste	Teste, (pakete) me 32 gropeza per identifikimin dhe percaktimin e ngarkeses mikrobike, si dhe vleresimin e ndjeshmerise ndaj antibiotikeve te mikroorganizmave te gjendur ne kampionin urinar. Pakete nje perdorimshme e mbyllur hermetikisht
85	Sistem per identifikimin e shkaktareve te infeksioneve mykotike	10(dhjetë) teste	Teste, (pakete)me 24 gropeza per identifikimin dhe vleresimin e ndjeshmerise ndaj antimykotikeve te mykerave me rendesi klinike. Pakete nje perdorimshme e mbyllur hermetikisht teste
86	Sistem per identifikimin e infeksioneve genitale	40(dyzet) teste	Teste. (pakete)me 32 gropeza per identifikimin dhe vleresimin e ndjeshmerise ndaj antibiotikeve te mkroorganizmave si Mycoplasma urogenitalis, Neiseria spp, Streptococcus B, Staphylococcus aureus, Escherichia coli, Gardnerrella vaginalis, Trichomonas vaginalis, Candida spp. Pakete nje perdorimshme e mbyllur hermetikisht
87	Clamydia	20(njëzet) teste	Teste, Pakete nje perdorimshme e mbyllur hermetikisht
88	Toxoplasmosis (jo aglutinim)	25(njëzetepesë) teste	Test i shpejtë, paketim individual

89	Syphilisis test	200(dyqind) teste	Sifiliz test i shpejtë, paketim individual
90	ASO	6x100 teste	600 teste, test i shpejte aglutinacion
91	CRP	10x100 teste	1000 teste, test i shpejte aglutinacion
92	RF	6x100 teste	600 teste, test i shpejte aglutinacion
93	Streptococcus Grup-A (teste të shpejta)	25(njëzet e pesë) teste	Teste nje perdorimshe, paketim individual
94	Helicobacter Pylori (Kit fece)	1000(njëmijë) teste	Teste, Test i shpejtë imunokromatografik, një përdorim, paketim individual
95	Klorur Natriumi	2(dy) flakon	Flakon 500 gr Pluhur ne ngjyrë të bardhë në kuti plastike i mbyllur hermetikisht
96	Fece gjak occult (FIT)	500(pesëqind) teste	Test, Test i shpejtë imunokromatografik, një përdorim paketim individual
97	Test Campylobacter	1x10 teste	Test i shpejte, kromatografik per detektimin cilesor te Campylobacter spp, ne kampionin e feces. Test i shpejte paketim individual
98	Bikromat Kaliumi	1(një)	Shishe plastike 1 kg me pluhur ngjyrë portokalli të theksuar i mbyllur hermetisht
99	Hidroksid Amoni	1(një)	Flakon 1litër në shishe qelqi kafe të errët

100	Fenolftaleine	1(një) flakon	Flakon 1kg në shishe qelqi kafe të errët
101	D.P.D(Diethyl-Paraphenylene-Diamine)	5x100 copë	500cope DPD Kërkohe në formë pluhuri ne ngjyrë të bardhë për arësye të aparatit Hana Instrument
102	Kromat kaliumi	1(një) flakon	Flakon 1kg në shishe plastike, pluhur në ngjyrë të bardhë.
103	Jodur Kaliumi	1(një) të mbyllur hermetikisht	Flakon 500 gr në shishe plastike pluhur në ngjyrë të bardhë
104	Acid Klorhidrik 0.1 N	5(pesë) litër	Fiksional 1liter në shishe plastike i bardhë
105	Sulfat Kaliumi	1(një) flakon	Flakon 1kg në shishe plastike në formë kristalesh në ngjyrë të bardhë
106	Kite për aparat spektrofotometer6600 UV-VIS/ose ekuivalentin e tij per NO ₃	5x25 teste	125teste.Tuba qelqi me solucion brenda gati për përdorim për vlefshmërinë e aparatit në laborator.
107	Kite per aparat spektrofotometer 6600UV-VIS/ose ekuivalentin e tij Per NH ₄	5x25 teste	125teste.Tuba qelqi me solucion brenda gati për përdorim për vlefshmërinë e aparatit në laborator.
108	Kite per aparat spektrofotometer 6600UV-VIS/ose ekuivalentin e tij Per NO ₂	5x25 teste	125teste. Tuba qelqi me solucion brenda gati për përdorim për vlefshmërinë e aparatit në laborator.

109	Kite per aparat spektrofotometer 6600UV-VIS/ose ekuivalentin e tij Per Hekur	2x25 teste	50teste. Tuba qelqi me solucion brenda gati për përdorim për vlefshmërinë e aparatit në laborator.
110	Kite per aparat spektrofotometer6600UV-VIS/ose ekuivalentin e tij Fortesi Totale	1x25 teste	25teste. Tuba qelqi me solucion brenda gati për përdorim për vlefshmërinë e aparatit në laborator.
111	Elermajer qelqi	5(pesë) copë	500 ml, material qelqi I shkallëzuar
112	Elermajer qelqi	5(pesë) copë	1000 ml, material qelqi i shkallëzuar
113	Elermajer qelqi	5(pesë) copë	2000 ml, material qelqi i shkallëzuar
114	Elermajer qelqi	5(pesë) copë	250 ml, material qelqi i shkallëzuar
115	Elermajer qelqi	5(pesë) copë	100 ml, material i shkallëzuar qelqi
116	Elermajer qelqi	5(pesë) copë	50 ml, material qelqi i shkallëzuar
117	Beker	5(pesë) copë	500 ml, material qelqi i shkallëzuar
118	Beker	5(pesë) copë	50 ml, material qelqi i shkallëzuar
119	Beker	5(pesë) copë	100 ml, material qelqi i shkallëzuar
120	Beker	5(pesë) copë	50 ml, material qelqi i shkallëzuar

121	Shishe qelqi per marrje mostr. Uji me tape te autoklavueshme	5(pesë) copë	Shishe qelqi 500ml me tapë blu sepse është rezistente ndaj nxehtësisë
122	Shishe qelqi per marrje mostr. Uji me tape te autoklav	20(njëzet) copë	Shishe qelqi 250ml me tapë blu sepse është rezistente ndaj nxehtësisë
123	Tuba qelqi ujrash 20x200 mm	300(treqind)copë	tuba qelqi neutral
124	Tuba qelqi ujrash 18x180 mm	210(dyqind e dhjetë) copë	Tuba qelqi neutral
125	Tuba qelqi me fileto 16x160 mm	50(pesëdhjetë)copë	Tuba qelqi neutral
126	Pjata petri qelqi ø 120	100(njëqind) copë	ø 120 material qelqi, kërkohet qelqi sepse është shumë përdorimshe dhe me këtë dimension realizohet plotësisht antibiograma.
127	Pjata petri plastike Ø90	2000(dymijë) copë	Pjata plastike Ø90, kërkohet me këtë dimension sepse shërben për mbjelljen e disa analizave specifike dhe kursim terreni.
128	Pjata petri plastikeØ 50-60	2999(dymijeente qindenentedhjetente) copë	Pjata plastike, Ø 50-60, kërkohet në këtë dimension sepse shërben për vendosjen e filtrit 47mm.
129	Tuba tamponash steril për marrje mostre	3000(tremijë) copë	Tub tamponi steril, material plastik
130	Llampa alkooli me fileto metalike	2(dy) copë	Llampa te jete me fileto metalike
131	Pipeta automatike 10-100µl	1(një) copë	Cope 10-100µl
132	Shiringa 2ml	1001(njëmijënjë) copë	Cope, shiringa sterile 2ml me maje 23 Gx1”
133	Ansa teli	20(njëzet) copë	Copë, Ø 4mm metalike, kërkohet me këtë dimension për kryerjen e analizës specifike që kryhet në laborator
134	Pambuk	200(dyqind) pako	Pako 100 gr

135	Koproxheta (Lamela)	1035(njëmije e tridhjetë e pesë) copë	Copë, material qelqi
136	Doreza Masa M , Masa L	150(njëqind e pesëdhjetë) pako	Në kuti (100) copë, Masa M -100 kuti Masa L- 50 kuti
137	Pulla krahu (mbas analizës)	3000(tremije) copë	Cope, në formë rrethore
138	Llastik për marrje gjaku (zhgut)	2(dy) copë	Llastik
139	Age sterile	100(njëqind) copë	cope
140	Stativ për mbajtje tubash me baze të mbyllur me baze të sheshte	10(dhjetë) copë	φ20 mm,160x275x70(në mm),
141	Dizinfektant për tavolinat	10(dhjetë) copë	Në litër, në bidon plastik në formë spray

Data e skadencës së mallit në ditën e lëvrimit të mallit në magazinën e institucionit, të jetë jo më pak se 1(një) vit nga data e lëvrimit të mallit në magazinë.

Specifikisht, për disa reagentë, data e skadencës së mallit në ditën e lëvrimit të mallit në magazinën e institucionit, të jetë jo më pak se 2 vjet e konkretisht si më poshtë:

Kliger Iron Agar
Trypton-tryptophan
Ekstrakt majaje
Ekstrakt mishi
Baird - Parker
Chloramphenicol
Bromthymol blu

DyPotasium Dyhydrogen Fosfat (K₂HPO₄)

Potasium Dyhydrogen Fosfat KH₂PO₄

Celuloid nitrat filter AC, SC 47mm

Laktoze

Typhy O

Typhy H

Brucella abortus

Brucella abortus kontroll positive

Kite për aparat spektrofotometer 6600 UV-VIS/ose ekuivalentin e tij për NO_3

Kite për aparat spektrofotometer 6600 UV-VIS/ose ekuivalentin e tij për NH_4

Kite për aparat spektrofotometer 6600 UV-VIS/ose ekuivalentin e tij për Hekur

Kite për aparat spektrofotometer 6600 UV-VIS/ose ekuivalentin e tij për NO_2

Kite për aparat spektrofotometer 6600 UV-VIS/ose ekuivalentin e tij Fortesi Totale

Skadenca e këtyre artikujve kërkohet 2 vjet për arsye se qarkullimi i tyre është më i ngadalshëm

Skadenca e Agar- gjak i gatshëm, në ditën e lëvrimit në magazinën e institucionit të jetë 2-3 muaj nga kjo ditë.

Njësia e prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurim për hedhjen e të dhënave në SPE.

NJËSIA E PROKURIMIT: